



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 191, Datë 17.09.2020

PËR MBARIMIN E STATUSIT TË MAGJISTRATIT

Bazuar në nenin 64, pika 1, germa "a" dhe 65, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe në nenin 189, pika 1, germa "a", të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ne kërkesën për dorëheqje nga detyra të z. Bujar Hoxha, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nëpërmjet kërkesës së regjistruar me nr. 1337 prot, datë 20.08.2020, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale, , Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për shkak dorëheqje, për z. Bujar Hoxha, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Dorëheqja jep efektet në datë 30.09.2020.
3. Të njoftohet për këtë vendim z. Bujar Hoxha, Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETARI
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

